



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 181 Nr. ifaq/Br.st/No.pg 61

Data/Datum/Date 20 101, 2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (e), nenit 51 paragrafi 51.2 dhe nenit 73 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 34, nenit 35, nenit 36 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, dhe raportit të Komisionit përzgjedhës me Nr. Prot. 01 Nr.178/24 i datës 18.01.2024, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2024 merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit

1. Miratohet vendimi për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit.
2. Anëtarë të Komitetit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi janë:
 - 2.1 Atdhe Rama;
 - 2.2 Almedina Jaha;
 - 2.3 Samra Kërçagu;
 - 2.4 , Altina Mezini dhe
 - 2.5 Selman Shtavica.
3. Mandati i anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Rahovecit është 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi edhe për një mandat 4 (katër) vjeçar.
4. Kompetencat e Komitetit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi janë: dhënia e propozimeve për rregullore të ndryshme; hulumtime të ndryshme; jep mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, Komitetet e Përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse; paraqet pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës; jep mendime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara; etj.
5. Për punën që do ta kryejnë anëtarë e Komitetit Konsultativ do të kompensohen nga 50€ (pesëdhjetë euro) për çdo mbledhje që do ta mbajnë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Rahovecit.
6. Anëtarët e komitetit konsultativ nuk mund të kompensohen për më shumë se gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e Komitetit, Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të komitetit,*
- *Kryesuesit të Kuvendit,*
- *Kryetarit të Komunës,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.181/24
Me datë:30.01.2024

